



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.39

2006

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9502
datë 3.4.2006

Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet
Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe
Artigiancassa S.P.A. për financimin e programit
“Menaxhimi i mbetjeve të ngurta të Tiranës” 1207

Ligj nr.9503
datë 3.4.2006

Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për
Kontratën e Transportit Rrugor Ndërkombëtar të Mallrave
(CMR) dhe Protokollin e
nënshkrimit..... 1217

L I G J
Nr.9502, datë 3.4.2006

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ARTIGIANCASSA S.P.A. PËR
FINANCIMIN E PROGRAMIT “MENAXHIMI I MBETJEVE TË NGURTA TË TIRANËS”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe ARTIGIANCASSA S.P.A. për financimin e programit “Menaxhimi i mbetjeve të ngurta të Tiranës””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4836, datë 25.4.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE FINANCIARE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
ARTIGIANCASSA S.P.A 6 000 000.00 EURO

PROGRAMI PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA TË TIRANËS

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (në vijim i quajtur si “Huamarrësi”), i përfaqësuar nga Ministria e Financave nga njëra anë, dhe Artigiancassa S.p.A., e listuar në regjistrin e bankave, me një kapital 35.000.000,00 me zyrë të regjistruar në Romë, Via Crescenzo del Monte 25, me Regjistrer të Kompanive, kodi i taksës no.01158450583, TVSH no.00968081000 (në vijim e quajtur “Artigiancassa”), si administratori i Fondit Qarkullues për Bashkëpunim Zhvillimi në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave të Italisë, i krijuar në përputhje me nenin 26 të ligjit italian nr.227 të 24 majit 1977, dhe më tej duke iu referuar nenit 6 të ligjit italian nr.49, të 26 shkurtit 1987, përfaqësuar nga Z. Carlo Larcinese nga ana tjetër (Artigiancassa dhe Huamarrësi së bashku do të quhen në vijim si “Palët”),

kanë vendosur këtë Marrëveshje financiare:

Neni 1

Përkufizime

Në këtë Marrëveshje dhe në anekset përkatëse, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet si vijojnë:
“Njohja e Borxhit”: do të thotë deklarimi që i referohet nenit 10, sipas të cilit Huamarrësi merr përsipër të shlyejë, në favor të Artigiancassa, kapitalin plus interesin lidhur me Huanë e Butë;

“Banka Agjente”: do të thotë institucioni financiar (Artigiancassa), i cili do të përfshihet në këto aktivitete:

- kontroll të dokumentacionit kontraktues;
- veprimet disbursuese;
- veprime të pagesave;

“Marrëveshje”: do të thotë Marrëveshja financiare aktuale, preambola dhe anekset përkatëse që formojnë një pjesë integrale;

“Banka Shqiptare” do të thotë banka e caktuar nga Huamarrësi si banka korresponduese e Artigiancassa që vepron si Bankë Agjente për qëllime të kësaj Marrëveshjeje;

Dokumentacioni Kontraktues”: do të thotë dokumentacioni që i referohet kontratës/kontratave të furnizimit (p.sh. faturat, llogaritë e ngarkesave, listat e paketimeve, punimet në proces);

“Periudha Falas”: do të thotë periudha, që zgjat 204 muaj, duke filluar nga data e disbursimit të parë;

“Autoritetet Kompetente Italiane”: do të thotë Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe /ose Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Italisë dhe/ose ndonjë njësi kompetente tjetër e Republikës Italiane, e emëruar për qëllime të kësaj Marrëveshjeje;

“MAE/DGCS”: do të thotë Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Italisë-Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim dhe Zhvillim;

“Program”: do të thotë projekti që lidhet me “Menaxhimin e mbetjeve të ngurta të Tiranës” (përfshirë, por jo i kufizuar në sigurinë e punëve në vendgrumbullimin e Sharrës; organizimin e mbledhjes dhe të transportit të mbetjeve të ngurta në zonat periferike urbane të Tiranës; forcimin menaxherial, teknik, kapaciteteve organizuese të personelit që është i ngarkuar me menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane; përgatitjen e rregulloreve dhe ligjeve kombëtare dhe rajonale për menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe mbrojtjen e mjedisit), i miratuar në bazë të Marrëveshjes Qeveritare nga Qeveria e Republikës së Italisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë, e financuar pjesërisht në kuptimin e Huasë së Butë;

“Njësia e Zbatimit të Projektit (NJZP)”: do të thotë njësia teknike e ngritur në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për zbatimin e programit;

“Hua e Butë”: do të thotë financimi që Artigiancassa, në bazë të autorizimit të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe sipas propozimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, do të akordojë në termat dhe kushtet e ofruara nga neni 1 dhe neni 3 i kësaj Marrëveshjeje;

“Kontrata/kontratat e furnizimeve”: do të thotë kontrata/kontratat tregtare që lidhen me furnizimin e mallrave dhe/ose të shërbimeve nga eksportuesit italianë tek importuesit shqiptarë në Shqipëri, që kanë të bëjnë me realizimin e programit.

Neni 2

Hyrje

2.1 Në kuptim të marrëveshjes së njohur si “Marrëveshje Qeveritare” (në vijim e referuar si “Marrëveshja Qeveritare”) e nënshkruar më 29 janar 2004 ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë, kjo e fundit është angazhuar të financojë programin e emërtuar “Menaxhimi i mbetjeve të ngurta të Tiranës” me anë të një huaje të butë me një maksimum prej 6,000,000.00 (gjashtë milionë) euro.

2.2 Në kuptim të kësaj Marrëveshjeje palët kanë si qëllim: (i) të zbatojnë financimet që lidhen me Huanë e Butë të përcaktuar në Marrëveshjen Qeveritare dhe (ii) të rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre në përputhje me Marrëveshjen Qeveritare.

2.3 Ministria e Ekonomisë dhe e Financave e Qeverisë së Republikës të Italisë, në bazë të propozimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Italisë, me dekretin nr.79144, datë 18 korrik 2005 ka autorizuar Artigiancassa t’i akordojë Huamarrësit një hua të butë në termat dhe kushtet e përcaktuara në nenet 3 dhe 6 të kësaj Marrëveshjeje (në vijim e referuar si “Huaja e Butë”) për qëllime të financimit të programit.

2.4 Artigiancassa për qëllime të kësaj Marrëveshjeje do të veprojë si Bankë Agjente dhe banka shqiptare do të jetë Raiffeisen Bank në Shqipëri.

Neni 3

Hua e Butë

3.1 Artigiancassa i akordon Huamarrësit dhe Huamarrësi nga kjo pranon huanë e butë me kushtet e mëposhtme:

- Shuma: maksimum deri në 6,000,000.00 (gjashtë milionë) euro;

- Kohëzgjatja: 38 vjet;
- Shlyerja: 42 (dyzet e dy) këste të principalit të barabarta gjysmëvjetore të njëpasnjëshme, i pari i të cilëve bëhet i pagueshëm 210 (dyqind e dhjetë) muaj prej datës së disbursimit të parë;
- Norma e interesit: nominale 0.10% në vit (zero pikë dhjetë për qind) e pagueshme në fund të çdo periudhe të 6 (gjashtë) muajve prej datës së çdo tërheqjeje.

- Qëllimi i kredisë: “Programi për menaxhimin e mbetjeve të ngurta të Tiranës”.

3.2 Huaja e Butë do të përdoret për sigurimin e mallrave dhe të shërbimeve me origjinë italiane. Një shumë maksimale prej 30 (tridhjetë)% e shumës referuar Huasë së Butë mund të përdoret për të mbuluar kostot lokale dhe të importimit të mallrave dhe shërbimeve me origjinë prej vendeve në zhvillim.

Secila dhe çdo kontratë, që lidhet me kostot lokale dhe importimin e mallrave, që e kanë origjinën nga vendet në zhvillim do të negociohet vetëm përmes dhe nënshkruhet nga një kontraktor/eksportues kryesor italian.

Kontratat e furnizimit do të jenë në euro.

3.3 Huaja e Butë nuk mund të përdoret për të financuar: taksat lokale, taksat doganore dhe TVSH-në.

3.4 Kontratat e furnizimit që lidhen me programin sipas nenit 2.1 do të prokurohen përmes ofertave publike të rezervuara për kompanitë italiane mbi bazën e procedurave të ofruara në “Manualin e Procedurave” (të përshtatura nga Komisioni Europian në 23 dhjetor 2002) lidhur me: shërbimet, furnizimet dhe kontratat e punimeve të financuara nga buxheti i përgjithshëm i Komisionit Europian në kontekstin e bashkëpunimit me vendet e treta.

3.5 Huaja e Butë do të bëhet e disponueshme në përputhje me termat dhe kushtet e vendosura në këtë Marrëveshje.

Neni 4

Bërja efektive e Marrëveshjes financiare

4.1 Kjo Marrëveshje do të bëhet efektive pasi Artigiancassa të ketë marrë prej Huamarrësit dokumentet e mëposhtme përmes Ambasadës Italiane - Ambasada/ Zyra e Bashkëpunimit:

- i) Një deklaratë nga autoriteti kompetent i Qeverisë së Republikës të Shqipërisë duke pasqyruar autoritetin e Huamarrësit për ta nënshkruar në emër të Qeverisë Shqiptare këtë Marrëveshje nga një person i autorizuar sipas rregullit, në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi dhe vepruese në Shqipëri dhe të marrë përsipër detyrimet e lindura nga kjo Marrëveshje.

- ii) Emërimin me shkrim nga një autoritet kompetent i Huamarrësit i personit/personave të autorizuar në mënyrë të rregullt për të nënshkruar këtë Marrëveshje (të vërtetuar nga Ambasada Italiane në Tiranë – Ambasada/Zyra e Bashkëpunimit), kërkesa për financim e kontratës së furnizimit në formën e aneksit A, dhe Njohjen e Borxhit në formën e aneksit C, referuar nenit 10 më poshtë. Një përcaktim i tillë duhet të specifikojë emrin dhe zyrën e këtij personi/personave dhe të përmbajë “specimentin” azhurnuar të firmave të tyre. Ndonjë ndryshim i kësaj (nëse ka ndonjë) duhet të transmetohet në kohë nga Huamarrësi tek Artigiancassa.

4.2 Artigiancassa, pasi të ketë marrë dokumentet e lartpërmendura dhe të jetë plotësisht e kënaqur me to, do të njoftojë Huamarrësin dhe bankën shqiptare me anë të letrës ose faksit, i cili pastaj duhet të pasohet nga një letër e konfirmuar, datën në të cilën kjo Marrëveshje do të bëhet efektive.

Neni 5

Termet për disbursimet e Huasë së Butë

5.1 Periudha e disbursimit të Huasë së Butë do të jetë 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga data e disbursimit të parë. Një periudhë e tillë mund të zgjatet nga Artigiancassa. Artigiancassa nuk mund të zgjasë periudhën e disbursimit në rast se Huamarrësi ose Autoritetet Kompetente Italiane nuk janë dakord për një shtyrje të tillë dhe të kenë njoftuar kështu me shkrim Artigiancassa së paku 30 (tridhjetë) ditë kalendarike para skadimit të datës së periudhës së disbursimit.

5.2 Në rast se periudha e disbursimit ka skaduar dhe nuk mund të zgjatet, Artigiancassa, pasi të jetë konsultuar me Autoritetet Kompetente Italiane, do të informojë Huamarrësin për anulimin e angazhimit të Artigiancassa-s në lidhje me fondet e papërdorura.

Neni 6

Kushtet dhe modalitetet për disbursimin e Huasë së Butë

6.1 Huaja e Butë mund të përdoret nga Huamarrësi pasi të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- i) autorizimin e dhënë nga Autoritetet Kompetente Italiane për të alokuar kontratën/kontratat e furnizimit të Huaja e Butë;
- ii) rezultate të kënaqshme nga kontrolli i bërë nga Artigiancassa sipas nenit 6.2 (i) më poshtë.
- iii) marrjen nga Artigiancassa të kërkesës së financimit të kontratës së furnizimit të parashikuar nga neni 7.1 më poshtë:

6.2 Pas marrjes së autorizimit të përmendur në pikën 6.1 (i) më sipër, Artigiancassa do të kryejë menjëherë veprimet si më poshtë:

i) Të bëjë kontrollin mbi bazën e kërkesës parashikuar nga Autoriteti Kompetent Italian mbi eksportuesin italian dhe mbi individët/kompanitë italiane, nëse ka, të përfshirë me organizatat lokale dhe mbi kontratën/kontratat e furnizimit. Në lidhje me kontratën/kontratat e furnizimit, Artigiancassa do të verifikojë që ato janë në përputhje me termat dhe kushtet e Huasë së Butë dhe që ato janë mjaftueshmërisht të detajuara përsa i përket zërave të kostove/çmimeve, në mënyrë që të lejojë kontrollet sipas nenit 8.3.

ii) Të njoftojë Huamarrësin dhe bankën shqiptare për marrjen e autorizimit sipas nenit 6.1 (i) më sipër dhe t'i kërkojë bankës shqiptare të nisë kërkesën e parashikuar sipas nenit 7.1.

6.3 Rezultatet e suksesshme të kontrollit të bërë nga Artigiancassa sipas nenit të mësipërm 6.2 (i), do të sjellë alokimin e kontratës/kontratave të furnizimit të Huaja e Butë. Financimi i kontratës së furnizimit do të bëhet vetëm pas plotësimit të kushteve të vendosura sipas nenit 6.1 (iii).

6.4 Artigiancassa do të njoftojë me letër ose telex/fax Huamarrësin, bankën shqiptare, NJZP-në dhe eksportuesin italian për alokimin, si dhe gjithashtu për financimin e kontratës/kontratave të furnizimit.

Neni 7

Kërkesa për financimin e kontratës së furnizimit

7.1 Pas njoftimit të rezultatit të kënaqshëm të kontrollit sipas nenit 6.2 (i), banka shqiptare duhet t'i transmetojë Artigiancassa-s një kërkesë për financimin e kontratës së furnizimit të nevojshme për pagesat e parashikuara në çdo kontratë furnizimi. Me anë të një kërkesë të tillë, e cila duhet të jetë në formën e aneksit A, Huamarrësi do të vërtetojë që kontrata/kontratat e furnizimit është/janë e/të pranueshme për t'u financuar dhe do të marrë përsipër t'i rimbursojë Artigiancassa-s shumën e disbursuar.

7.2 Kërkesa për financimin e kontratës së furnizimit të bërë sipas nenit 7.1 do të merret në afatin e caktuar dhe asnjë herë më vonë se gjashtë muaj prej datës së njoftimit prej Artigiancassa-s të parashikuar në bazë të nenit 6.4 më sipër ose kushtit (nëse ka ndonjë) të shprehur në kontratën e furnizimit. Pas skadimit të periudhës së lartpërmendur Artigiancassa, pas konsultimit me Autoritetin Kompetent Italian, do ta konsiderojë anulimin e mundshëm të kontratës/kontratave të furnizimit të alokuara të Huaja e Butë.

Neni 8

Disbursimet

8.1 Kërkesa për financimin e çdo kontrate furnizimi, e parashikuar sipas nenit 7, do të bëhet nga banka shqiptare në raport me çdo pagesë për t'u bërë në përputhje me kushtet e shprehura në kontratën e furnizimit, pas dorëzimit të dokumentacionit kontraktues.

8.2 Eksportuesi italian do të dorëzojë dokumentacionin kontraktues dhe do të kërkojë disbursimin e shumës përkatëse në përputhje me kontratën e furnizimit në formën e aneksit B. Një kopje origjinale e dokumentacionit kontraktues do t'i dërgohet në të njëjtën kohë nga Artigiancassa bankës shqiptare dhe NJZP-së.

8.3 Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike prej datës së dërgimit nga Artigiancassa të dokumentacionit kontraktues të mësipërm, NJZP do të njoftojë me shkrim Artigiancassa-n dhe me një kopje bankën shqiptare për përputhjen e furnizimit të mallrave dhe/ose shërbimeve me dokumentacionin kontraktues përkatës.

8.4 Në vijim të marrjes së çdo kërkesë për disbursim, Artigiancassa do të kontrollojë dokumentacionin kontraktues. Një kontroll i tillë do të përfshijë përputhshmërinë e dokumentacionit kontraktues me kontratën e furnizimit përkatëse.

8.5 Pas çdo hetimi të suksesshëm të bërë sipas nenit 8.3 dhe kontrolli të suksesshëm të bërë sipas nenit 8.4 Artigiancassa do të disbursojë shumën përkatëse në llogari brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve

kalendarike prej datës së marrjes të çdo kërkesë për disbursim dhe konfirmon me telex ose fax në bankën shqiptare dhe Ministrinë e Financave për shumën totale të disbursimit dhe datën në të cilën i është kredituar fondi eksportuesit/eksportuesve italian/ë.

8.6 Artigiancassa do të bëjë pagesat në favor të eksportuesit/eksportuesve italian/ë dhe do të marrë prej eksportuesit/eksportuesve italian/ë të tillë faturën e shkarkimit të bërë sipas aneksit D në dy origjinalë njëra prej të cilave do t'i dorëzohet bankës shqiptare.

8.7 Në vijim të çdo pagese në favor të eksportuesit/eksportuesve italian/ë, Artigiancassa do t'i dërgojë Huamarrësit dhe bankës shqiptare një pasqyrë të përditësuar të shlyerjeve, e cila të tregojë të gjitha shumat e disbursuara deri në dhe përfshirë disbursimin e fundit, duke treguar datat përkatëse të tyre në përputhje me nenin 9 më poshtë. Huamarrësi do të konfirmojë me shkrim pranimin e tij për pasqyrën e mësipërme të pagesave të përmendura më lart.

Neni 9

Shlyerja e Huasë së Butë dhe pagesa e interesit

9.1 Çdo shumë e disbursuar do të ripaguhet në përputhje me pasqyrën e shlyerjeve në 42 (dyzet e dy) këste të njëpasnjëshme të barabarta të ndara në çdo gjashtë muaj (më poshtë të quajtuara si Këstet e Principalit), i pari i të cilëve do të bëhet i pagueshëm 210 (dyqind e dhjetë) muaj nga disbursimi i parë. Artigiancassa do t'i dërgojë Huamarrësit dhe bankës shqiptare pasqyrën e shlyerjeve në përputhje me nenin 8.7.

9.2 Për këstet e principalit të kredituara efektivisht, të papaguara, interesi i vonësës do të llogaritet me një normë vjetore prej 0.1% (zero pikë një përqind) e barabartë me 0.05% (zero pikë zero pesë për qind) për gjysmën e vitit, prej datës në të cilën fondet kanë qenë kredituar deri në datën e shlyerjes të këstit të fundit të principalit. Interesi do të llogaritet në numrin e ditëve aktualisht të kaluara mbi bazën e muajit tridhjetë ditësh dhe të një viti prej treqind e gjashtëdhjetë ditësh (30/360).

9.3 Gjatë periudhës së shlyerjes, interesi do të paguhet në të njëjtën datë të përcaktuar për këstin e principalit. Gjatë periudhës falas, interesi do të paguhet çdo 6 (gjashtë) muaj në datat korresponduese, në ditët dhe muajt, të datave të shlyerjes të kësteve të principalit. Kësti i parë i interesit mund t'i referohet një periudhe prej më pak se gjashtë muajsh. Megjithatë, nëse kjo periudhë do të jetë më pak se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike kësti i interesit korrespondues do të paguhet së bashku me këstin e interesit pasues. Kësti i parë i interesit, që lidhet me një periudhë prej më shumë se gjashtë muaj ose më pak se gjashtë muaj, do të llogaritet mbi bazën e ditëve aktuale që numërohen midis datës së pagesës së tij, mbi bazën e një periudhe gjashtë mujore të 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve kalendarike.

9.4 Pagesa e interesit që lidhet me çdo disbursim duhet të bëhet në datat e përcaktuara të paraqitura në pasqyrën e pagesave të parashtruar në nenin 8.7, deri në datën e dorëzimit të njohjes së borxhit referuar nenit 10 më poshtë; për periudhën pasuese shlyerja e principalit dhe pagesat e interesit do të bëhen në datat e përcaktuara të treguara në pasqyrën e shlyerjeve bashkëngjitur njohjes së borxhit të lartpërmendur.

9.5 Banka shqiptare, në emër të Huamarrësit, merr përsipër të bëjë pa vonësë të gjitha pagesat dhe shlyerjet që rezultojnë nga kjo Marrëveshje, si dhe gjithashtu nga njohja e borxhit, në datën e përcaktuar aktuale, për shumën korresponduese në euro, në favor të Artigiancassa ose personit/personave të autorizuar nga ajo. Shuma të tilla do të kreditohen pa zbritjet e ndonjë banke dhe/ose të normës së shkëmbimit dhe/ose taksave dhe pa lajmërim të saj nga Artigiancassa ose personat e autorizuar prej saj.

Neni 10

Dorëzimi i njohjes së borxhit

10.1 Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve kalendarike prej datës së skadimit të disbursimit të fundit të Huasë së Butë të shprehur në nenin 5.1, Huamarrësi do t'i dorëzojë Artigiancassa-s njohjen e borxhit të nënshkruar siç duhet dhe të sigluar në çdo faqe në formën e aneksit C.

10.2 Pasqyra e shlyerjeve të shprehura në njohjen e borxhit do të kompletohet duke mbledhur të gjitha këstet e principalit dhe të interesit akoma të pamaturuara dhe këstet të cilat janë maturuar, por nuk janë paguar në datën e dorëzimit të njohjes së borxhit, të parashikuar në pasqyrën e shlyerjeve përkatëse për çdo disbursim, në përputhje me kushtet e nenit 8.7.

10.3 Artigiancassa do të depozitojë njohjen e borxhit për regjistrim dhe administrim të saj dhe herë pas here do të shënojë në njohjen e borxhit pagesat e principalit dhe të interesit së bashku me këstet e mundshme të cilat janë maturuar, por nuk janë paguar. Sapo të gjitha pagesat e parashikuara në njohjen e borxhit do të jenë bërë, Artigiancassa do t'i kthejë njohjen e borxhit Huamarrësit të nënshkruar siç duhet e të vërtetuar.

Neni 11

Angazhimi i Huamarrësit

11.1 Angazhimi i Huamarrësit për të paguar shumat e detyrueshme sipas kësaj Marrëveshjeje dhe njohjen e borxhit në lidhje me të është i pavarur, absolut i pakushtëzuar dhe i parevokueshëm.

Neni 12

Pengesat dhe forcat madhore

12.1 Në rast të pengesave për zbatimin e programit për shkak të forcave madhore (si luftë, përmbytje, zjarr tërmet, konflikte pune dhe greva, veprime të ndonjë qeverie, vështirësi të papritura të transportit, punës apo rasteve të tjera) do të aplikohen kushtet e specifikuar në Marrëveshjen Qeveritare. Artigiancassa do të ndjekë udhëzimet e Autoritetit Kompetent Italian lidhur me aktivitetet e programit.

Neni 13

Pezullimi i disbursimeve

13.1 Gjatë periudhës së disbursimit të Huasë së Butë, Artigiancassa rezervon të drejtën për të pezulluar ndonjë kërkesë disbursimi sipas nenit 8, në rast të ndonjë mospërmbushje përkundrejt Artigiancassa-s sipas kësaj Marrëveshjeje ose kredive të tjera financiare të dhëna nga Republika e Italisë Qeverisë ose Bankës Qendrore ose Agjencive Shtetërore të Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 6 të ligjit nr.38 të 9 shkurtit 1979 dhe të nenit 6 të ligjit nr.49 të 26 shkurtit 1987 të Republikës së Italisë, si dhe të amendimeve të tij kohë pas kohe. Artigiancassa do të informojë në kohë Huamarrësin dhe bankën shqiptare për pezullim të tillë.

13.2 Artigiancassa do të ekzekutojë çdo kërkesë disbursimi parashikuar sipas nenit 8 në rast se shumat korresponduese janë bërë disponibël nga Autoriteti Kompetent Italian. Artigiancassa nuk do të gjykohej përgjegjëse përballë Huamarrësit në rast se shumat për t'u disbursuar sipas Huasë së Butë nuk do të bëhet disponibël nga Autoriteti Kompetent Italian.

Neni 14

Interesvonesa

14.1 Nëse për ndonjë arsye, çfarëdoqoftë, Artigiancassa nuk merr shumat detyrim për principalin dhe/ose interesin në datën kur ato janë detyrim për t'u paguar, Huamarrësi do të jetë i detyruar t'i paguajë Artigiancassa-s, mbi shumën e përmendur, interesvonesa, që nga data e detyrimit deri në datën e kreditimit efektiv në favor të Artigiancassa-s ose të personit/ave të caktuar për këtë.

14.2 Ky interesvonesë, që rrjedh nga dështimi për të vepruar, do të përlogaritet duke zbatuar formulën e interesit të thjeshtë me një normë prej 0,1%(zero presje një për qind) për periudhën prej 35 (tridhjetë e pesë) ditëve kalendarike, menjëherë vijuese, nga data origjinale e detyrimit, dhe më pas, me një normë prej 2,6%(dy presje gjashtë për qind) deri në datën e kreditimit efektiv të Artigiancassa-s. Ky i dyti, do të përditësohet nga Autoritetet Kompetente Italiane; një përditësim i tillë do të ndodhë nga 1 janari 2007.

14.3 Rishikimi ka si qëllim sjelljen e interesvonesës në të njëjtën linjë me, dhe për asnjë arsye jo më të lartë se Norma Reference e Interesit Tregtar (NRIT) e publikuar çdo muaj nga OECD.

Neni 15

Taksat

15.1 Çdo taksë prezente ose të ardhme, të cilat mund të jenë të detyruara në Shqipëri për çfarëdo arsyeje të lidhur me këtë Marrëveshje dhe me njohjen e borxhit, do të jenë në ngarkim të Huamarrësit.

15.2 Ndonjë taksë detyruese në Itali, lidhur me këtë Marrëveshje, nuk do të jetë në ngarkim të Huamarrësit.

15.3 Artigiancassa deklaron që do t'i nënshtrohet statusit të taksave parashikuar sipas nenit 19 të dekretit të Presidentit të Republikës nr.601 të 29 shtatorit 1973, të amenduar herë pas here.

Neni 16

Ligji qeverisë

16.1 Kjo Marrëveshje do të qeveriset dhe rregullohet në përputhje me ligjin italian.

Neni 17

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

17.1 Palët veç kësaj do të përpiqen të zgjidhin miqësisht ndonjë mosmarrëveshje që ngrihet ose del prej interpretimit dhe/ose performancës së marrëveshjes.

17.2 Nëse këto përpjekje nuk çojnë në ndonjë zgjidhje të mosmarrëveshjes brenda një periudhe kohore të arsyeshme, mosmarrëveshja do të zgjidhet në një nivel qeveritar.

17.3 Nëse edhe kjo përpjekje do të dështonte ose (nëse përpjekja është bërë) nuk do të jepte një rezultat të kënaqshëm, të gjitha mosmarrëveshjet e ngritura prej ose në lidhje me marrëveshjen do të zgjidhen përfundimisht sipas rregullave të arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris, Francë, nga një gjyq arbitrazhi prej tre arbitrash:

- një arbitër i emëruar nga Huamarrësi;
- një arbitër i emëruar nga Artigiancassa;
- arbitri i tretë do të emërohet nga arbitrat e lartpërmendur ose, në rast mosmarrëveshje në mes tyre, nga kryetari i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris.

17.4 Nëse Huamarrësi ose Artigiancassa nuk emërojnë arbitrat e tyre brenda 30 (tridhjetë) ditësh prej kërkesës së palës tjetër, ky arbitër do të emërohet nga kryetari i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris.

17.5 Vendimi i gjyqit të arbitrazhit, i cili do të vendosë në përputhje me ligjin e Republikës Italiane, do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm pa kushte për të dyja palët, pa ndonjë mundësi apelimi.

17.6 Asnjë mosmarrëveshje ose debat që mund të ngrihet ndërmjet palëve për më tepër nuk do të pezullojë detyrimet e huamarrësit për të paguar, në datën e përcaktuar të rënë dakord, të gjitha shumat e përcaktuara sipas kësaj Marrëveshjeje dhe në veçanti të gjitha shumat që rezultojnë prej pasqyrës së shlyerjeve të shprehura në nenin 8 më sipër dhe prej njohjes së borxhit që lidhet me të.

Neni 18

Njoftime

18.1 Njoftimet për t'u dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje do të adresohen si më poshtë:

Ministria e Financave: Bulevardi Dëshmorët e Kombit- Tirana- Albania Tel: +355 (4) 250264 – Fax 355(4)228494;

Raiffeisen Bank in Albania: Rruga e Kavajës–Tirana–Tel + 355(4)22609 – fax +355(4)229304

Artigiancassa S:P:A: Via Crescenzo del Monte”% - Romë – Italy Nucleo Operativo Lex N: 49/1987 N:Telephone 0039-06-5845529-561-414 Telefax N, 0039-06-5845466....

Neni 19

Tekstet origjinale të Marrëveshjes financiare

19.1 Kjo Marrëveshje nënshkruhet në tre kopje në anglisht.

SHTOJCA A

Nga : Banka Raiffeisen në Shqipëri

Për : Artigiancassa S.p.A.

Marrëveshja Financiare për..... (.....) euro, e nënshkruar nga, nëmëdhe nga Artigiancassa nëmë

Në zbatim të nenit 7 të Marrëveshjes financiare të lartpërmendur, do të donim t'ju informojmë se kontrata e furnizimit, këtu, bashkëngjitur, nr..... datë..... midis dhe lidhur me (Programin/Projektin), është e kualifikuar për financim.

Si rrjedhojë, ne ju kërkojmë që të financoni shumën përkatëse prej euro (.....) e cila i korrespondon pagesave, detyrim nga ana jonë, për(eksportuesi italian), që ju do të duhet të kryeni në përputhje me termat e kontratës së furnizimit.

Për këtë qëllim, ne njohim faktin se pagesat që ju do të duhet të bëni në favor të eksportuesit italian, të treguara nga vetë ne, do të jenë subjekt i: (i) dorëzimit prej këtij eksportuesi të Dokumenteve Kontraktuale (si: faturat, fletë-ngarkesa, lista e paketimit, situacion i punimeve etj.), (ii) rezultatit pozitiv nga verifikimi i Dokumenteve Kontraktuale sipas nenit 8.3 dhe 8.5 të Marrëveshjes financiare, (iii) dhe lëshimi i dokumentit të vërtetimit të faturës së paguar në dy kopje origjinale.

Në këtë kuptim, ju do të na dërgoni origjinalin e Dokumenteve Kontraktuale, si dhe dy origjinale të dokumentit të vërtetimit të faturës së paguar.

Me anë të kësaj, ne, Ju konfirmojmë se Qeveria e, merr përsipër, pa kushte dhe në mënyrë të pakthyeshme, të ripaguajë çdo shumë të kredituar nga Ju tek eksportuesit italianë, në përputhje me termat dhe kushtet e parashikuara sipas Marrëveshjes financiare.

Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga skadimi i afatit të fundit të disbursimit të Kredisë së Butë, të caktuar më parë në nenin 5 të Marrëveshjes financiare, ne, marrim përsipër të lëshojmë një "Njohje të të Qenit në Borxh" për shumën principale, e cila korrespondon me shumën e të gjitha disbursimeve të bëra sipas Marrëveshjes financiare.

Kjo "Njohje e të Qenit në Borxh" do të jetë sipas formularit në shtojcën C të Marrëveshjes financiare.

Juaji sinqerisht,

(Formulari i Kërkesës për Disbursim)

SHTOJCA B

Nga:(Eksportuesi italian)

Për : Artigiancassa S.p.A.

Marrëveshja financiare për..... (.... ..) euro, nënshkruar nga nëmëdhe nga Artigiancassa S.p.A., nëmë

Të nderuar zotërinj,

Duke iu referuar Kontratës se furnizimit, nr.datëmes nesh dhe(importues) për shumën prej (.... ..) euro lidhur me(Programin /Projektin), ne ju dërgojmë Dokumentet Kontraktuale që vijojnë:

.....
.....
.....
.....

Ne ju kërkojmë juve të disbursoni shumën e lartpërmendur brenda 45 ditësh nga dita e marrjes së kësaj kërkesë në llogarinë bankare që vijon (Banka e Eksportuesit Italian).

BBAN çelur në emër tëBanka :Nr. telefoni i zyrës së degës nr. faks i zyrës së degës.....

Juaji sinqerisht,

Datë

Nënshkrimi

Ne, me këtë, konfirmojmë autenticitetin e nënshkrimit

.....

(Banka e Eksportuesit Italian)

(Formulari i Njohjes së të Qenit në Borxh)

SHTOJCA C

.....(Huamarrësi)

Nr.

Vendi dhe data e lëshimit:

.....

Referuar Marrëveshjes financiare ndërmjet(Huamarrësi), i cili vepron në emër dhe për llogari të Qeverisë sëdhe Artigiancassa, e nënshkruar në mëdhe në më,..... (Huamarrësi) njeh marrjen e shumave që vijojnë nga Artigiancassa :

.....më

.....më.....
.....më

Për këtë,(Huamarrësi), me anë të kësaj, deklaron pa kushte dhe në mënyrë të pakthyeshme, të jetë debitor ndaj Artigiancassa, si administratore e Fondit Qarkullues për bashkëpunim e zhvillim, në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF) të Italisë - me seli në Romë (Itali), Via Crescenzo del Monte 25, për shumën principale prej (.... ...) euro, të cilën ai merr përsipër ta ripagujë në(....) këste të barabarta, gjashtëmujore, të njëpasnjëshme, i pari i të cilëve do të bëhet detyrim për t'u paguar më dhe i fundit më , sipas grafikut të ripagimit, të caktuar më parë, këtu dhe më poshtë.

Në shumën e veçantë të principalit të kësaj “Njohje të të Qenit në Borxh”.....(Huamarrësi), merr përsipër të paguajë interesin të cilit i është bërë referencë në grafikun e ripagimit të caktuar më parë dhe këtu e më poshtë, i përlogaritur në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes financiare.

.....(Huamarrësi) do të ripagujë këstet e principalit dhe interesin e parashikuar në këtë “Njohje të të Qenit në Borxh”, duke kredituar shumat përkatëse në euro, në datën e detyrimit, e rënë dakord, në favor të Artigiancassa, ose të personit/ave të caktuar për këtë, me zyrën e degës në Romë të....., të zhveshur nga çdo tarifë shërbimi e bankës dhe/ose këmbimi.

Nëse zyra e degës në Romë e....., për ndonjë arsye çfarëdo, duke përfshirë edhe për arsye jashtë kontrollit të Huamarrësit, nuk merr në datën e detyrimit, shumat detyrim për principalin dhe interesin, të parashikuara në “Njohjen e të Qenit në Borxh”, Huamarrësi do të jetë i detyruar t'i paguajë zyrës së degës në Romë të....., interesvonesë mbi këto shuma, që nga data e detyrimit deri në datën e kreditimit efektiv në favor të Artigiancassa ose të personit/ave të caktuar për këtë.

Ky interesvonesë do të përlogaritet me normën për periudhën e ditëve që vijojnë menjëherë nga data origjinale e detyrimit dhe më tej, me normën deri në datën e kreditimit efektiv në favor të Artigiancassa.

.....
(sigla e Huamarrësit)
vazhdon

SHTOJCA C vijon

Ky interes i fundit, i lidhur me dështimin për të vepruar, do të përditësohet nga Autoritetet Kompetente Italiane.

Interesi për dështimin për të vepruar, do të përlogaritet duke zbatuar formulën e interesit të thjeshtë.

Zyra e degës në Romë edo të shënojë, kohë pas kohe, në këtë “Njohje të të Qenit në Borxh”, çdo pagesë të principalit dhe të interesit.

Menjëherë sapo të jenë kryer të gjitha pagesat e listuara në grafikun e ripagimit, i caktuar më parë dhe këtu e në vijim, kjo “Njohje e të Qenit në Borxh”, do t'i kthehet(Huamarrësi).

Kjo “Njohje e të Qenit në Borxh”, është lëshuar në zbatim të Kredisë së Butë prej (.....) euro , dhënë në përputhje me nenin 6 të ligjit nr. 49 të 26 shkurtit 1987.

GRAFIKU I RIPAGIMIT

Data e Maturimit	Këste Principali	Këste Interesi	Shuma
a)			
b)			
c)			
d)			
1			
2			
3			
4			
5			
6			
7			
8			
9			

10

(Nënshkrimi i Huamarrësit)

SHTOJCA D

Nga : Eksportuesi italian
Për: Banka Raiffeisen ne Shqipëri
Për : Artigiancassa S.p.a

VËRTETIM PËR FATURË TË PAGUAR

Duke iu referuar Kontratës së Furnizimit nrnënshkruar më mes shoqërisë sonë dhepër furnizimin e, ne, me anë të kësaj, konfirmojme se kemi marrë shumën prej (.... ...) EURO si pagese e pjesshme/totale e kësaj Kontrate Furnizimi.

Kjo shume, lidhet me Kredinë e Butë prej..... (.... ...) EURO, të dhënë nga Artigiancassa, për Qeverinë e, në zbatim të Nenit 6 të Ligjit nr. 49 të 26 Shkurtit, 1987, me ndryshimet e pësuara, me ane të Marrëveshjes Financiare të nënshkruar në mëdhe nëmë.....

Ne, për këtë, me anë të kësaj, deklarojmë të jemi paguar tërësisht për shumën detyrim sipas Kredisë së Butë si pagesë për shumën prej Euro dhe se Huamarrësi dhe Artigiancassa, nuk janë përgjegjës për ndonjë apo për të gjitha komisionet dhe përgjegjësitë e lidhura me shumën e marrë.

Nënshkrimi

Ne, me këtë konfirmojme autenticitetin e nënshkrimit

.....

Banka e Eksportuesit Italian

L I G J

Nr.9503, datë 3.4.2006

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN PËR KONTRATËN E TRANSPORTIT RRUGOR NDËRKOMBËTAR TË MALLRAVE (CMR) DHE PROTOKOLLIN E NËNSHKRIMIT

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën për Kontratën e Transportit Rrugor Ndërkombëtar të Mallrave (CMR) dhe Protokollin e nënshkrimit.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4837, datë 25.4.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONVENTA

MBI KONTRATËN PËR TRANSPORTIN RRUGOR NDËRKOMBËTAR TË MALLRAVE (CMR)

Bërë në Gjenevë, më 19 Maj 1956

PREAMBULË

Palët kontraktuese,
duke njohur dobinë e standardizimit të kushteve që rregullojnë kontratën për transportin rrugor ndërkombëtare të mallrave, sidomos në lidhje me dokumentet për këtë transport dhe përgjegjësinë e transportuesit,
ranë dakord si më poshtë:

KAPITULLI I
FUSHA E ZBATIMIT

Neni 1

1. Kjo Konventë zbatohet për çdo kontratë të transportit rrugor të mallrave në automjete me shpërblim, ku vendi i marrjes në dorëzim të mallrave dhe vendi i caktuar për dorëzim, sipas parashikimit në kontratë, ndodhen në dy vende të ndryshme, nga të cilët njëri është vend kontraktues, pavarësisht nga vendbanimi ose shtetësia e palëve.

2. Për qëllimet e kësaj Konvente, “automjete” janë mjetet motorike, maunat dhe automjetet me rimorkio dhe gjysmërimorkio, siç parashikohet në nenin 4 të Konventës mbi Trafikun Rrugor, të datës 19 Shtator 1949.

3. Kjo Konventë zbatohet edhe nëse transporti që përfshihet në fushën e saj të zbatimit kryhet nga shtete ose institucione apo organizata qeveritare.

4. Kjo Konventë nuk zbatohet:

- a) për transportin e kryer në bazë të kushteve të Konventës Portare Ndërkombëtare;
- b) për transportet funerale;
- c) për transportin e mobilieve.

5. Palët kontraktuese bien dakord për të mos ndryshuar asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente me anë të marrëveshjeve të veçanta ndërmjet dy ose më shumë prej tyre, përveçse për ta bërë atë të pazbatueshme në trafikun e brendshëm ose për të autorizuar në operacionet e transportit të kufizuara tërësisht në territorin e tyre përdorimin e faturave të shoqërimit të mallit që përfaqësojnë pronësinë mbi mallin.

Neni 2

1. Nëse automjeti që mbart mallin transportohet në një pjesë të udhëtimit me rrugë detare, hekurudhore, ujëra të brendshme ose rrugë ajrore dhe, përveç kur zbatohen dispozitat e nenit 14, malli nuk shkarkohet nga automjeti, kjo Konventë zbatohet për të gjithë transportin. Nëse dhe në masën e provuar se çdo humbje, dëm ose vonesë në dorëzimin e mallit që shkaktohet gjatë transportit me mjete të tjera të transportit nuk është shkaktuar nga transportuesi rrugor, por nga ndonjë rrethanë që mund të ndodhte gjatë dhe për shkak të transportit me mjetin tjetër të transportit, përgjegjësia e transportuesit rrugor nuk përcaktohet nga kjo Konventë por në mënyrën në të cilën do të përcaktohej përgjegjësia e transportuesit me mjetin tjetër të transportit, nëse do të ishte bërë një kontratë për transportimin e mallit vetëm nga dërguesi dhe transportuesi me mjetin tjetër të transportit në pajtim me kushtet e parashikuara nga ligji për transportin e mallit me mjetin tjetër të transportit. Megjithatë, nëse nuk ka kushte të tilla të parashikuara, përgjegjësia e transportuesit rrugor përcaktohet nga kjo Konventë.

2. Nëse transportuesi rrugor është po i njëjti transportues me mjetin tjetër të transportit, përgjegjësia e tij përcaktohet gjithashtu në pajtim me dispozitat e paragrafit të parë të këtij neni, por sikur ai të ishte dy persona të ndryshëm në cilësinë e transportuesit rrugor dhe me mjetin tjetër të transportit.

KAPITULLI II
PERSONAT PËR TË CILËT TRANSPORTUESI ËSHTË I PËRGJEGJSHËM

Neni 3

Për qëllimet e kësaj Konvente, transportuesi është i përgjegjshëm për veprimet ose mosveprimet e agentëve dhe shërbyesve të tij, dhe të personave të tjerë, shërbimet e të cilëve ai i përdor për të kryer

transportin, nëse këta agjentë, shërbyes ose persona të tjerë veprojnë në kuadrin e punësimit të tyre, sikur këto veprime ose mosveprime të ishin të tijat.

KAPITULLI III LIDHJA DHE ZBATIMI I KONTRATËS SË TRANSPORTIT

Neni 4

Kontrata e transportit konfirmohet duke përpiluar një faturë për shoqërimin e mallit. Mungesa, parregullsia ose humbja e faturës shoqëruese të mallit nuk ka efekt mbi ekzistencën ose vlefshmërinë e kontratës së transportit që mbetet e rregulluar nga dispozitat e kësaj Konvente.

Neni 5

1. Fatura shoqëruese e mallit përpilohet në tri kopje origjinale të nënshkruara nga dërguesi dhe nga transportuesi. Këto nënshkrime mund të shtypen ose të zëvendësohen nga vula e dërguesit dhe transportuesit nëse këtë e lejon ligji i vendit ku është përpiluar fatura shoqëruese e mallit. Kopja e parë i jepet dërguesit, e dyta shoqëron mallin dhe e treta mbahet nga transportuesi.

2. Nëse malli që do të transportohet duhet të ngarkohet në automjete të ndryshme apo është i llojeve të ndryshme ose do të ndahet të pjesë të ndryshme, dërguesi ose transportuesi do të ketë të drejtën të kërkojë një faturë të veçantë shoqëruese për mallin që duhet të përgatitet për çdo automjet të përdorur, për çdo lloj ose për çdo pjesë të mallit.

Neni 6

1. Fatura shoqëruese e mallit përmban hollësitë e mëposhtme:
 - a) Datën e faturës shoqëruese të mallit dhe vendin në të cilin ajo është përpiluar;
 - b) Emrin dhe adresën e dërguesit;
 - c) Emrin dhe adresën e transportuesit;
 - d) Vendin dhe datën e marrjes në dorëzim të mallit dhe vendin e caktuar për t'u dorëzuar;
 - e) Emrin dhe adresën e marrësit;
 - f) Përshkrimin në përgjithësi të natyrës së mallit dhe metodën e paketimit, dhe, në rastin e mallrave të rrezikshëm, përshkrimin e tyre përgjithësisht të njohur;
 - g) Numrin e paketave dhe shenjat, si dhe numrat e tyre të veçantë,
 - h) Peshën bruto të mallit ose sasinë e tyre të shprehur ndryshe;
 - i) Tarifat që lidhen me transportin (tarifat e transportit, tarifatat shtesë, tarifatat doganore dhe tarifa të tjera që shkarkohen nga përpilimi i kontratës deri në momentin e dorëzimit);
 - j) Udhëzimet e nevojshme për doganën dhe formalitetet e tjera;
 - k) Një deklaratë që transporti, pavarësisht nga ndonjë dispozitë me efekt të kundërt, i nënshtrohet dispozitave të kësaj Konvente.
2. Sipas rastit, fatura shoqëruese e mallit përmban edhe hollësitë e mëposhtme:
 - a) Një deklaratë që ringarkimi nuk lejohet;
 - b) Tarifatat që merr përsipër të paguajë dërguesi;
 - c) Shumën e tarifave të "pagesave në momentin e dorëzimit";
 - d) Një deklaratë për vlerën e mallit dhe shumën që përfaqëson interes të veçantë për dorëzimin;
 - e) Udhëzimet e dërguesit për transportuesin në lidhje me sigurimin e mallit;
 - f) Afati kohor që është rënë dakord për kryerjen e transportit;
 - g) Një listë të dokumenteve që i dorëzohet transportuesit.
3. Palët mund të përfshijnë në faturën shoqëruese të mallit çdo hollësi tjetër që atyre mund t'u duket e dobishme.

Neni 7

1. Dërguesi është i përgjegjshëm për të gjitha shpenzimet, humbjen ose dëmin e pësuar nga transportuesi për shkak të pasaktësisë ose papërshtatshmërisë së:
 - a) hollësive të përcaktuara në nenin 6 paragrafi 1, (b), (d), (e), (f), (g), (h) dhe (j);
 - b) hollësive të përcaktuara në nenin 6 paragrafi 2;
 - c) çdo hollësie ose udhëzimi tjetër të dhënë prej tij për të mundësuar përpilimin e faturës shoqëruese të mallit ose për t'u përfshirë në të.

2. Nëse, me kërkesën e dërguesit, transportuesi përfshin në faturën shoqëruese të mallit hollësitë e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, ai mendohet ta ketë bërë këtë, nëse nuk vërtetohet e kundërta, në emër të dërguesit.

3. Nëse fatura shoqëruese e mallit nuk e përmban deklaraten e përcaktuar në nenin 6 paragrafi 1 (k), transportuesi është i përgjegjshëm për të gjitha shpenzimet, humbjen dhe dëmin e pësuar nëpërmjet këtyre mosveprimeve nga personi që ka të drejtën të disponojë mbi mallin.

Neni 8

1. Gjatë marrjes në dorëzim të mallit, transportuesi kontrollon:

a) saktësinë e deklarimeve në faturën shoqëruese të mallit në lidhje me numrin e paketave dhe shenjat, dhe numrat e tyre, dhe

b) gjendjen e jashtme të mallrave dhe paketimin e tyre.

2. Nëse transportuesi nuk ka mjete të arsyeshme për të kontrolluar saktësinë e deklarimeve të përmendura në paragrafin 1 (a) të këtij neni, ai përfshin rezervat e tij në faturën shoqëruese të mallit së bashku me arsyet ku ai i mbështet ato. Ai gjithashtu përcakton arsyet për çdo rezervë që ai bën në lidhje me gjendjen e jashtme të mallit dhe paketimin e tij. Këto rezerva nuk e detyrojnë dërguesin, përveç kur ai ka rënë shprehimisht dakord për të qenë i detyruar prej tyre në faturën shoqëruese të mallit.

3. Dërguesi ka të drejtë t'i kërkojë transportuesit të kontrollojë peshën bruto të mallit ose sasinë e tij të shprehur ndryshe. Ai mund të kërkojë gjithashtu që të kontrollohet përmbajtja e pakove. Transportuesi ka të drejtë të pretendojë koston për një kontroll të tillë. Rezultati i kontrollit shënohet në faturën shoqëruese të mallit.

Neni 9

1. Fatura shoqëruese e mallit është provë prima facie e lidhjes së kontratës së transportit, kushteve të kontratës dhe marrjes në dorëzim të mallit nga transportuesi.

2. Nëse fatura shoqëruese e mallit nuk përmban ndonjë rezervë të veçantë nga transportuesi, presumohet, nëse nuk provohet e kundërta, se malli dhe paketimi i tij dukej se ishte në gjendje të mirë kur u mor në dorëzim nga transportuesi dhe numri i pakove, shenjat dhe numrat e tyre korrespondojnë me faturën shoqëruese të mallit.

Neni 10

Dërguesi është i përgjegjshëm kundrejt transportuesit për dëmin e shkaktuar personave, pajisjeve ose mallrave të tjerë; dhe për të gjitha shpenzimet për shkak të paketimit të parregullt të mallit, përveç kur parregullsia ishte e dukshme ose transportuesi kishte dijeni në momentin e marrjes në dorëzim të mallit dhe ai nuk ka bërë rezervë për këtë.

Neni 11

1. Për qëllimet e doganës ose formaliteteve të tjera që duhet të përfundohen para dorëzimit të mallit, dërguesi i bashkëngjit faturës shoqëruese të mallit të gjitha dokumentet e nevojshme ose i vë në dispozicion të transportuesit dhe i jep atij të gjithë informacionin që ai i kërkon.

2. Transportuesi nuk është i detyruar të hetojë për saktësinë ose përshtatshmërinë e këtyre dokumenteve ose informacioni. Dërguesi është i përgjegjshëm para transportuesit për çdo dëm që shkaktohet nga mungesa, papërshtatshmëria ose parregullsia e këtyre dokumenteve ose këtij informacioni, përveç në rastin e veprimit të gabuar ose neglizhimit nga ana e transportuesit.

3. Përgjegjësia e transportuesit për pasojat që rrjedhin nga humbja ose përdorimi i pasaktë i dokumenteve të përcaktuara në faturën shoqëruese të mallit dhe që e shoqërojnë atë, ose të depozituara tek transportuesi është ajo e agentit, me kusht që kompensimi që paguhet nga transportuesi nuk e kalon atë që paguhet në rastin e humbjes së mallit.

Neni 12

1. Dërguesi ka të drejtë ta shesë mallin, veçanërisht duke i kërkuar transportuesit ta ndalojë mallin në transit, të ndryshojë vendin në të cilin duhet të bëhet dorëzimi ose t'ia dorëzojë mallin një marrësi tjetër të ndryshëm nga marrësi që është në faturën shoqëruese të mallit.

2. Kjo e drejtë pushon se ekzistuari pasi t'i jetë dorëzuar marrësit kopja e dytë e faturës shoqëruese të mallit, ose kur marrësi ushtron të drejtën në bazë të nenit 13 paragrafi 1; që nga ai moment transportuesi

plotëson porositë e marrësit.

3. Megjithatë, marrësi ka të drejtën e shitjes që nga momenti i përpilimit të faturës shoqëruese të mallit, nëse dërguesi bën një shënim për këtë qëllim në faturën shoqëruese të mallit.

4. Nëse në ushtrim të së drejtës së shitjes marrësi ka porositur dorëzimin e mallit te një person tjetër, ky i fundit nuk ka të drejtë të caktojë marrës tjetër.

5. Ushtrimi i së drejtës së shitjes u nënshtrohet kushteve të mëposhtme:

a) Që dërguesi ose, në rastin e parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, marrësi që dëshiron të ushtrojë këtë të drejtë jep kopjen e parë të faturës shoqëruese të mallit në të cilën janë shënuar udhëzimet e reja për transportuesin dhe zhëdmtton transportuesin në lidhje me të gjitha shpenzimet, humbjen dhe dëmtimin që lidhet me zbatimin e këtyre udhëzimeve të reja.

b) Që zbatimi i këtyre udhëzimeve është i mundshëm në momentin kur udhëzimet mbërrijnë te personi që duhet t'i zbatojë ato dhe nuk ndërhyjnë në aktivitetin normal të sipërmarrjes së transportuesit dhe nuk cenojnë porositë e tjera të dërguesit ose marrësit.

c) Që udhëzimet nuk shkaktojnë ndarje të porosisë.

6. Nëse për shkak të dispozitave të paragrafit 5(b) të këtij neni transportuesi nuk mund të zbatojë udhëzimet që ai ka marrë, ai njofton menjëherë personin që i ka dhënë atij udhëzimet.

7. Një transportues që nuk ka zbatuar udhëzimet e dhëna sipas kushteve të parashikuara në këtë nen ose që i ka zbatuar ato pa kërkuar t'i jepet kopja e parë e fatuës shoqëruese të mallit, ai përgjigjet para personit që ka të drejtë të ngrejë pretendim në lidhje me çdo humbje ose dëmtim të shkaktuar nga kjo.

Neni 13

1. Pas mbërritjes së mallit në vendin e caktuar për t'u dorëzuar, marrësi ka të drejtë t'i kërkojë transportuesit t'i japë atij, kundrejt një fature, kopjen e dytë të faturës shoqëruese të mallit dhe mallin. Nëse provohet humbja e mallit, ose nëse malli nuk ka mbërritur edhe pas kalimit të afatit të parashikuar në nenin 19, marrësi ka të drejtë të ushtrojë në emër të tij kundër transportuesit të gjitha të drejtat që rrjedhin nga kontrata e transportit.

2. Marrësi që ushtron të drejtat e parashikuara për të në paragrafin 1 të këtij neni paguan të gjitha tarifat që kërkojnë në faturën shoqëruese të mallit, por në rast mosmarrëveshjeje për këtë çështje transportuesit nuk i kërkohet të dorëzojë mallin, përveç kur nga marrësi jepet garanci.

Neni 14

1. Nëse për një arsye të caktuar bëhet i pamundur zbatimi i kontratës në pajtim me kushtet e parashikuara në faturën shoqëruese të mallit para se malli të arrijë vendin e caktuar për dorëzim, transportuesi kërkon udhëzime nga personi që ka të drejtën të bëjë shitjen e mallit në pajtim me dispozitat e nenit 12.

2. Megjithatë, nëse rrethanat janë të tilla që lejojnë transportin të kryhet në kushte të ndryshme nga ato të parashikuara në faturën shoqëruese të mallit dhe nëse transportuesi nuk ka qenë në gjendje të marrë udhëzime në një afat të arsyeshëm nga personi që ka të drejtën e shitjes së mallit në pajtim me dispozitat e nenit 12, ai ndërmerr ato hapa që duken se për të janë në favor të interesave të larta të personit që ka të drejtën të shesë mallin.

Neni 15

1. Nëse rrethanat nuk lejojnë që të bëhet dorëzimi i mallit pas mbërritjes së tij në vendin e caktuar për dorëzim, transportuesi i kërkon udhëzime dërguesit. Nëse marrësi e refuzon mallin, dërguesi ka të drejtën t'a shesë atë pa qenë i detyruar të japë kopjen e parë të faturës shoqësuese të mallit.

2. Edhe nëse marrësi e refuzon mallin, ai megjithatë mund të kërkojë dorëzimin e mallit nëse transportuesi nuk ka marrë udhëzime të tjera nga dërguesi.

3. Nëse rrethanat që pengojnë dorëzimin e mallit dalin pasi marrësi, në ushtrim të të drejtave të tij sipas nenit 12 paragrafi 3, ka dhënë një porosi për t'iu dorëzuar malli një personi tjetër, paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni zbatohen sikur marrësi të ishte dërgues dhe personi tjetër të ishte marrësi.

Neni 16

1. Transportuesi ka të drejtën e kompensimit të shpenzimeve të kërkesa e tij për udhëzime dhe

të të gjitha shpenzimeve që shkaktohen nga zbatimi i këtyre, përveç kur këto shpenzime u shkaktuan nga veprimi i gabuar ose neglizhenca e transportuesit.

2. Në rastet e përmendura në nenin 14 paragrafi 1 dhe në nenin 15, transportuesi mund ta shkarkojë mallin për llogari të personit që ka të drejtën ta shesë atë dhe me këtë transporti konsiderohet i përfunduar. Transportuesi e mban mallin në emër të personit që e ka këtë të drejtë. Megjithatë, ai mund t'ia besojë atë një pale të tretë dhe në këtë rast ai nuk ka asnjë përgjegjësi përveçse për të treguar kujdesin e arsyeshëm në zgjedhjen e kësaj pale të tretë. Tarifat që paguhen në bazë të faturës shoqëruese të mallit dhe të gjitha shpenzimet e tjera paguhen kundrejt marrjes së mallit.

3. Transportuesi mund ta shesë mallin pa pritur udhëzime nga personi që ka të drejtën e shitjes së tij, nëse malli mund të priset ose gjendja e tij e kërkon këtë veprim, ose kur shpenzimet e magazinimit nuk do të ishin në raport me vlerën e mallit. Ai mund ta bëjë shitjen e mallit edhe në raste të tjera, nëse pas kalimit të një afati të arsyeshëm ai nuk ka marrë nga personi që ka të drejtën e shitjes së mallit udhëzime për të kundërtën e asaj që atij do t'i kërkohej normalisht për ta zbatuar.

4. Nëse malli shitet në bazë të këtij neni, të ardhurat nga shitja, pasi të jenë zbritur shpenzimet që paguhen me marrjen e mallit, vihen në dispozicion të personit që ka të drejtën e shitjes së mallit. Nëse këto tarifa janë më të larta se të ardhurat nga shitja, transportuesi ka të drejtën e diferencës.

5. Procedura në rastin e shitjes vendoset në bazë të ligjit ose zakonisht të vendit ku ndodhet malli.

KAPITULLI IV PËRGJEGJËSIA E TRANSPORTUESIT

Neni 17

1. Transportuesi përgjigjet për humbjen tërësore ose pjesore të mallit dhe për dëmtimin e tij, që ndodh nga momenti kur ai merr në dorëzim mallin deri në momentin e dorëzimit, si dhe për çdo vonesë në dorëzim.

2. Megjithatë, transportuesi lirohet nga përgjegjësia nëse humbja, dëmtimi dhe vonesa janë shkaktuar nga veprimi i gabuar ose neglizhenca e pretenduesit, nga udhëzimet e pretenduesit të dhëna jo për shkak të veprimit të gabuar ose neglizhencës nga ana e transportuesit, nga vesi i brendshëm i mallit ose nga rrethanat që transportuesi nuk mund t'i mënjanojë dhe pasojat e të cilave ai nuk ishte në gjendje t'i parandalonte.

3. Transportuesi nuk lirohet nga përgjegjësia për shkak të gjendjes me defekt të automjetit që përdoret prej tij për të kryer transportin ose për shkak të veprimit të gabuar, ose neglizhencës së personit nga i cili ai mund të ketë marrë me qira automjetin ose të agjentëve ose shërbyesve të këtij të fundit.

4. Në bazë të nenit 18, paragrafët 2 deri 5, transportuesi lirohet nga përgjegjësia nëse humbja ose dëmtimet që rrjedhin nga rreziqet e veçanta që janë në një ose me shumë prej rrethanave të mëposhtme:

a) përdorimi i automjeteve të hapura të pambuluara, nëse për përdorimin e tyre është rënë shprehimisht dakord dhe parashikuar në faturën shoqëruese të mallit;

b) mungesa ose gjendja me defekt e paketimit në rastin e mallit që, nga natyra e tij, mund të firojë ose dëmtohet nëse nuk është i paketuar ose nuk është paketuar si duhet;

c) trajtimi, ngarkimi, ruajtja gjatë transportit ose shkarkimi i mallit nga dërguesi, marrësi ose personi që vepron në emër të dërguesit ose marrësit;

d) natyra e disa llojeve të mallrave që i ekspozon ata kundrejt humbjes së plotë ose pjesore ose dëmtimit; sidomos nëpërmjet thyerjes, ndryshkjes, kalbëzimit, tharjes, rrjedhjes, firos së zakonshme ose veprimit të molës, ose insekteve;

e) pamjaftueshmëria ose papërshtatshmëria e shenjave, ose, numrave nëpër pako;

f) transportimi i kafshëve.

5. Nëse në bazë të këtij neni transportuesi nuk ka përgjegjësi në lidhje me ndonjë faktor që ka shkaktuar humbjen, dëmtimin ose vonesën, ai përgjigjet deri në atë masë që ata faktorë, për të cilët ai mban përgjegjësi në bazë të këtij neni, kanë kontribuar në humbjen, dëmtimin ose vonesën.

Neni 18

1. Barra e provës për të provuar se humbja, dëmtimi ose vonesa ishte për shkak të një prej shkaqeve të parashikuara në nenin 17 paragrafi 2 i bie transportuesit.

2. Nëse transportuesi vërteton se në rrethanat e çështjes humbja ose dëmtimi mund të ishte për

shkak të një ose disa prej rreziqeve të veçanta të parashikuara në nenin 17 paragrafi 4, presumohet se ai u shkaktua në këtë mënyrë. Megjithatë, pretenduesi ka të drejtën të provojë se humbja ose dëmtimi faktikisht nuk ishte plotësisht ose pjesërisht si rezultat i këtyre rreziqeve.

3. Ky prezumim nuk zbatohet në rrethanat e parashikuara në nenin 17 paragrafi 4(a), nëse ka pasur një pakësim jo të zakonshëm ose humbje të ndonjë pakoje.

4. Nëse transporti kryhet në automjete të pajisura në mënyrë të veçantë për të mbrojtur mallin nga efektet e të nxehtit, të ftohtit dhe ndryshimet në temperaturë ose të lagështirës së ajrit, transportuesi nuk ka të drejtë të pretendojë privilegjin e nenit 17 paragrafi 4(d), nëse nuk provon se janë marrë të gjitha hapat që kërkohen prej tij në rrethanat që kanë të bëjnë me zgjedhjen, mirëmbajtjen dhe përdorimin e kësaj pajisjeje dhe se ai ka përmbushur të gjitha udhëzimet e veçanta që i janë dhënë atij.

5. Transportuesi nuk ka të drejtë të pretendojë privilegjin e nenit 17 paragrafi 4(f), nëse ai nuk provon se janë ndërmarrë të gjitha hapat që kërkohen prej tij dhe se ai ka përmbushur çdo udhëzim të veçantë që i është dhënë.

Neni 19

Vonesa në dorëzim konsiderohet të ketë ndodhur nëse malli nuk është dorëzuar brenda afatit kohor që është rënë dakord ose, nëse nuk ka afat kohor të tillë, kohëzgjatja faktike e transportit, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes dhe sidomos në rastin e ngarkesave të pjesshme, koha që nevojitet për realizimin e një ngarkese të plotë normalisht e tejkalon kohën që do të ishte e arsyeshme për një transportues të kujdesshëm.

Neni 20

1. Fakti që malli nuk është dorëzuar brenda tridhjetë ditëve pas kalimit të afatit kohor të rënë dakord ose, nëse nuk ka afat kohor të tillë, brenda gjashtëdhjetë ditëve nga momenti kur transportuesi ka marrë në dorëzim mallin, është provë përfundimtare për humbjen e mallit dhe personi që ka të drejtë të ngrejë një pretendim në lidhje me këtë mund ta konsiderojë atë të humbur.

2. Personi që ka këtë të drejtë, me marrjen e kompensimit për mallin e humbur, mund të kërkojë me shkrim që ai të njoftohet menjëherë nëse malli gjendet brenda vitit pas pagesës së kompensimit. Atij i jepet njohja me shkrim në lidhje me këtë kërkesë.

3. Brenda tridhjetë ditëve nga marrja e një njoftimi të tillë, personi që ka të drejtën e sipërpërmendur mund të kërkojë që malli t'i dorëzohet atij kundrejt pagesës së tarifave që duhet të paguhet në bazë të faturës shoqëruese të mallit dhe kundrejt kthimit të kompensimit që ka marrë duke zbritur të gjitha tarifat që përfshihet në të pa cenuar ndonjë pretendim për kompensim në lidhje me ndonjë vonesë në dorëzim në bazë të nenit 23 dhe, sipas rastit, nenit 26.

4. Në mungesë të kërkesës së parashikuar në paragrafin 2 ose të ndonjë udhëzimi të dhënë brenda afatit prej tridhjetë ditësh të parashikuar në paragrafin 3, apo nëse malli nuk është gjetur brenda një viti nga pagesa e kompensimit, transportuesi ka të drejtë ta trajtojë atë në pajtim me ligjin e vendit ku ndodhet malli.

Neni 21

Nëse malli i është dorëzuar marrësit pa marrë tarifën e “parasë në dorë në momentin e dorëzimit” e cila duhej të merrej nga transportuesi në bazë të kushteve të kontratës së transportit, transportuesi përgjigjet kundrejt dërguesit për një kompensim që nuk e kalon shumën e një tarife të tillë, duke mos cenuar të drejtën e tij për të ngritur padi kundrejt marrësit.

Neni 22

1. Nëse dërguesi i jep transportuesit mall me një natyrë të rrezikshme, ai e informon transportuesin në lidhje me natyrën e saktë të rrezikut dhe nëse është e nevojshme tregon masat që duhet të merren. Nëse një informacion i tillë nuk është shënuar në faturën shoqëruese të mallit, barra për të provuar me mjete të tjera se transportuesi e dinte natyrën e saktë të rrezikut që rrjedh nga ky mall i bie dërguesit ose marrësit.

2. Malli me natyrë të rrezikshme që në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni nuk dihej nga transportuesi se ishte i rrezikshëm, mund të shkarkohen, shkatërrohen ose të neutralizohen nga transportuesi në çdo vend dhe kohë pa kompensim; për më tepër, dërguesi përgjigjet për shpenzimet, humbjen ose dëmin që shkaktohet nga dhënia e tyre për transport ose nga transporti i tyre.

Neni 23

1. Nëse në bazë të dispozitave të kësaj Konvente, një transportues përgjigjet për kompensimin në lidhje me humbjen tërësore ose pjesore të mallit, ky kompensim llogaritet duke iu referuar vlerës së mallit në vendin dhe kohën në të cilën ai u pranua për transport.

2. Vlera e mallit caktohet në bazë të çmimit të bursës së mallrave ose, nëse nuk ka çmim të tillë, në bazë të çmimit aktual të tregut, ose, nëse nuk ka çmim në bursën e mallrave ose çmim aktual në treg, në bazë të vlerës normale të mallit të të njëjtit lloj dhe cilësi.

3. Megjithatë kompensimi nuk i kalon 25 franga për kilogram të peshës bruto. “Frangë” është frangë ari që peshon 10/31 e gramit dhe me pastërti 900.

4. Përveç kësaj, tarifë e transportit, tarifat doganore dhe tarifat e tjera të paguara për transportin e mallit kthehen tërësisht në rastin e humbjes së plotë dhe proporcionalisht me humbjen e pësuar në rastin e humbjes së pjesshme, por nuk paguhet për asnjë dëm tjetër.

5. Në rastin e vonesës, nëse pretenduesi provon që dëmi është shkaktuar nga kjo, transportuesi paguan kompensim për këtë dëm që nuk kalon tarifën e transportit.

6. Kompensim më i lartë mund të paguhet vetëm kur vlera e mallit ose një interes i veçantë në dorëzim është deklaruar në pajtim me nenet 24 dhe 26.

Neni 24

Dërguesi, nëpërmjet pagesës së një tarife shtesë për të cilën bie dakord, mund të deklarojë në faturën shoqëruese të mallit një vlerë për mallin e cila e kalon kufirin e caktuar në nenin 23 paragrafi 3 dhe në këtë rast, shuma e vlerës së deklaruar zëvendëson këtë kufi.

Neni 25

1. Në rastin e dëmit, transportuesi përgjigjet për atë shumë që malli ka pësuar rënie në vlerë, të llogaritur duke iu referuar vlerës së mallit të caktuar në pajtim me nenin 23, paragrafët 1, 2 dhe 4.

2. Kompensimi megjithatë nuk mund të kalojë:

- a) nëse është dëmtuar i gjithë malli i dërguar, shumën e pagueshme në rastin e humbjes së plotë;
- b) nëse është dëmtuar vetëm një pjesë e mallit të dërguar, shumën e pagueshme në rastin e humbjes së pjesës përkatëse.

Neni 26

1. Dërguesi, me anë të pagesës së një tarife shtesë për të cilën bie dakord, mund të caktojë shumën e një interesi të veçantë në dorëzim në rastin e humbjes ose dëmtimit, ose të kalimit të afatit kohor që është rënë dakord, duke shënuar këtë shumë në faturën shoqëruese të mallit.

2. Nëse është bërë deklarimi i një interesi të veçantë në dorëzim, kompensimi për humbjen ose dëmin shtesë të provuar mund të pretendohet deri në shumën e plotë të interesit të deklaruar, pavarësisht nga kompensimi i parashikuar në nenet 23, 24 dhe 25.

Neni 27

1. Pretenduesi ka të drejtë të pretendojë interesin për kompensimin e pagueshëm. Ky interes, i llogaritur me pesë për qind në vit, fillon nga data në të cilën pretendimi i është dërguar me shkrim transportuesit ose, nëse nuk është ngritur një pretendim i tillë, nga data në të cilën ka filluar procesi gjyqësor.

2. Nëse shumat në të cilat bazohet llogaritja e kompensimit nuk janë shprehur në valutën e vendit në të cilën pretendohet pagesa, konvertimi bëhet me kursin e këmbimit të ditës dhe vendit të pagesës së kompensimit.

Neni 28

1. Në rastet kur në bazë të ligjit të zbatuar humbja, dëmtimi ose vonesa që shkaktohet nga transporti në bazë të kësaj Konvente bëhet shkak për pretendime jashtëkontraktuale, transportuesi mund t'u referohet dispozitave të kësaj Konvente që përjashtojnë përgjegjësinë e tij ose që caktojnë ose kufizojnë kompensimin që duhet paguar.

2. Në rastet e përgjegjësisë jashtëkontraktuale të një prej personave për të cilin transportuesi është i përgjegjshëm në bazë të kushteve të nenit 3 për humbjen, dëmtimin ose vonesën, ky person mund t'u referohet gjithashtu dispozitave të kësaj Konvente që përjashtojnë përgjegjësinë e transportuesit apo caktojnë ose kufizojnë kompensimin që duhet paguar.

Neni 29

1. Transportuesi nuk ka të drejtë t'u referohet dispozitave të këtij kapitulli që përjashtojnë ose kufizojnë përgjegjësinë e tij ose që e kalojnë barrën e provës nëse dëmi është shkaktuar nga veprimi i qëllimshëm ose nga një mosveprim i tillë që, në pajtim me ligjin e gjykatës ose autoritetit që shqyrton çështjen, konsiderohet si i barasvlershëm me veprimin e qëllimshëm.

2. E njëjta dispozitë zbatohet nëse veprimi i qëllimshëm ose mosveprimi kryhet nga agjentët ose shërbyesit e transportuesit ose nga persona të tjerë shërbimet e të cilëve ai i përdor për të kryer transportin, nëse këta agjentë, shërbyes ose persona të tjerë veprojnë në kuadrin e punësimit të tyre.

KAPITULLI V PRETENDIMET DHE PADITË

Neni 30

1. Nëse marrësi pranon dorëzimin e mallit pa kontrolluar si duhet gjendjen e tij me transportuesin ose pa i dërguar këtij rezervat e tij duke i dhënë një përshkrim të përgjithshëm për humbjen ose dëmtimin, jo me vonë se momenti i dorëzimit në rastin e humbjes ose dëmtimit të dukshëm dhe brenda shtatë ditëve nga dorëzimi, ku ditët e diela dhe festat publike përjashtohen, në rastin kur humbja ose dëmtimi nuk është i dukshëm, fakti i pranimit të dorëzimit është provë *prima facie* që ai ka pranuar mallin në gjendjen e përshkruar në faturën shoqëruese të mallit. Në rastin kur humbja ose dëmtimi nuk është i dukshëm, rezervat përkatëse bëhen me shkrim.

2. Nëse gjendja e mallit është kontrolluar rregullisht nga marrësi dhe transportuesi, pranohen prova që kundërshtojnë rezultatin e këtij kontrolli vetëm në rastin kur humbja ose dëmtimi nuk është i dukshëm dhe me kusht që marrësi t'i ketë dërguar rregullisht rezervat me shkrim transportuesit brenda shtatë ditëve, ku ditët e diela dhe festat publike përjashtohen, nga data e kontrollit.

3. Nuk paguhet kompensim për vonesë në dorëzim, përveç kur i është dërguar transportuesit një rezervë me shkrim brenda njëzet e një ditëve nga momenti që malli është vënë në dispozicion të marrësit.

4. Në llogaritjen e afateve kohore të parashikuara në këtë nen, përkatësisht data e dorëzimit, data e kontrollit ose data kur malli u vu në dispozicion të marrësit nuk llogaritet.

5. Transportuesi dhe marrësi i japin njëri-tjetrit ndihmë të arsyeshme për të bërë hetime dhe kontrolle të përshtatshme.

Neni 31

1. Në proceset gjyqësore që lindin nga transporti në bazë të kësaj Konvente, paditësi mund të ngrejë padi në çdo gjykatë ose autoritet të një vendi kontraktues që është caktuar me marrëveshje ndërmjet palëve dhe, përveç kësaj, në gjykatat ose autoritetet e një vendi në territorin e të cilit:

a) i padituri ka vendbanimin e zakonshëm ose ka vendin kryesor të biznesit, ose degën apo agjencinë nëpërmjet së cilës u përpilua kontrata e transportit; ose

b) ndodhet vendi ku u mor në dorëzim malli nga transportuesi ose vend i caktuar për t'u dorëzuar.

2. Nëse në lidhje me një pretendim të parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni është ngritur padi para një gjykate ose autoriteti kompetent në bazë të këtij paragrafi, ose nëse në lidhje me një pretendim të tillë është dhënë një vendim nga një gjykatë ose autoritet, nuk ngrihet padi tjetër ndërmjet të njëjtave palë dhe për të njëjtat shkaqe nëse vendimi i gjykatës ose i autoritetit para së cilës u ngrit padia e parë nuk është i paekzekutueshëm në vendin në të cilin fillon gjykimi i ri.

3. Nëse një vendim i dhënë nga një gjykatë ose autoritet i një vendi kontraktues për një padi sipas

parashikimit të paragrafit 1 të këtij neni është bërë i ekzekutueshëm në atë vend, ai bëhet i ekzekutueshëm në secilin nga shtetet e tjera kontraktues menjëherë sapo të jenë përmbushur formalitetet e duhura në vendin përkatës. Këto formalitete nuk lejojnë që të rishqyrtohet themeli i çështjes.

4. Dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni zbatohen për vendimet e dhëna në fund të gjykimit, vendimet në mungesë dhe pajtimet e konfirmuara me vendim gjykate, por nuk zbatohen për vendimet paraprake ose për vendimet për njohjen e dëmeve, që u shtohen shpenzimeve të një paditësi që ka dështuar plotësisht ose pjesërisht me padinë e tij.

5. Nuk kërkohet garanci për shpenzimet në gjykimet që lindin për shkak të transportit në bazë të kësaj Konvente nga shtetas të vendeve kontraktuese që kanë vendbanimin ose vendin e biznesit në një prej këtyre vendeve.

Neni 32

1. Afati i parashkrimit për paditë që ngrihen për shkak të transportit në bazë të kësaj Konvente është një vit. Megjithatë, në rastin e veprimit të qëllimshëm ose të mosveprimit që në bazë të ligjit të gjykatës ose autoritetit që shqyrton çështjen konsiderohet si veprim i qëllimshëm, afati i parashkrimit është tre vjet. Afati i parashkrimit fillon:

- a) në rastin e humbjes së pjesshme, dëmtimit ose vonesës në dorëzim, nga data e dorëzimit;
- b) në rastin e humbjes së plotë, nga dita e tridhjetë pas kalimit të afatit kohor të rënë dakord ose, nëse nuk ka afat kohor të rënë dakord, nga dita e gjashtëdhjetë duke filluar nga data në të cilën malli është marrë në dorëzim nga transportuesi;
- c) në të gjitha rastet e tjera, me kalimin e një afati prej tre muajsh pas përpilimit të kontratës së transportit.

Dita në të cilën fillon afati i parashkrimit nuk llogaritet brenda në afat.

2. Një pretendim me shkrim e pezullon afatin e parashkrimit deri në atë datë që transportuesi e hedh poshtë pretendimin me anë të një njoftimi me shkrim dhe kthen dokumentet që i bashkëngjiten asaj. Nëse pranohet një pjesë e pretendimit, afati i parashkrimit fillon përsëri vetëm në lidhje me atë pjesë të pretendimit që është i debatueshëm. Barra e provës në lidhje me marrjen e pretendimit ose të përgjigjes dhe të kthimit të dokumenteve i bien asaj pale që mbështetet mbi këto fakte. Afati i parashkrimit nuk pezullohet nga pretendime të tjera me të njëjtin objekt.

3. Në pajtim me dispozitat e paragrafit 2 të mësipërm, zgjatja e afatit të parashkrimit rregullohet nga ligji i gjykatës ose autoritetit që shqyrton çështjen. Ky ligj rregullon edhe lindjen e së drejtës për padi në të ardhmen.

4. E drejta e padisë që është parashkruar nuk mund të ushtrohet me anë të kundërpadisë ose kompensimit në proces.

Neni 33

Kontrata e transportit mund të përmbajë një dispozitë që t'i delegojë kompetencë një gjykatë arbitrazhi nëse kjo dispozitë që i delegon këtë kompetencë gjykatës së arbitrazhit parashikon që kjo gjykatë do të zbatojë këtë Konventë.

KAPITULLI VI

DISPOZITA NË LIDHJE ME TRANSPORTIN E KRYER NGA DISA TRANSPORTUES

Neni 34

Nëse transporti i rregulluar nga një kontratë kryhet nga disa transportues rrugorë, secili prej tyre ka përgjegjësi për kryerjen e të gjithë operacionit, transportuesi i dytë dhe çdo transportues pasues bëhen palë të kontratës së transportit, në kushtet e faturës shoqëruese të mallit dhe bazuar në pranimin e mallit dhe të faturës shoqëruese të mallit.

Neni 35

1. Një transportues që pranon mallin nga një transportues tjetër i jep këtij të fundit një faturë me datë dhe firmë. Ai shënon emrin dhe adresën e tij në kopjen e dytë të faturës shoqëruese të mallit. Sipas rastit, ai shënon në kopjen e dytë të faturës shoqëruese të mallit dhe në faturën e tij rezervat e llojit të

parashikuar në nenin 8 paragrafi 2.

2. Dispozitat e nenit 9 zbatohen për marrëdhëniet ndërmjet disa transportuesve.

Neni 36

Përveç rastit të kundërpadisë ose kompensimit në një proces për një padi në lidhje me një pretendim bazuar në të njëjtën kontratë transporti, proceset gjyqësore në lidhje me humbjen, dëmtimin ose vonesën mund të fillohen vetëm kundër transportuesit të parë, transportuesit të fundit ose transportuesit që ka kryer atë pjesë të transportit gjatë të cilit ka ndodhur ngjarja që ka shkaktuar humbjen, dëmtimin ose vonesën; padia mund të ngrihet njëkohësisht kundër disa prej transportuesve.

Neni 37

Një transportues që ka paguar kompensim në pajtim me këtë Konventë ka të drejtën e rimbursimit të këtij kompensimi së bashku me interesat e tij dhe të gjitha shpenzimet që ka bërë në lidhje me pretendimin, nga transportuesit e tjerë që kanë marrë pjesë në transport, në pajtim me dispozitat e mëposhtme:

a) Transportuesi i përgjegjshëm për humbjen ose dëmtimin ka i vetëm detyrimin e kompensimit pavarësisht nëse paguan vetë apo një transportues tjetër;

b) Nëse humbja ose dëmtimi është shkaktuar nga veprimi i dy ose më shumë transportuesve, secili prej tyre paguan një shumë në raport me pjesën e tij të detyrimit; nëse është e pamundur të ndahet detyrimi, secili transportues ka detyrimin në raport me atë pjesë të pagesës për transportin që ai duhet të marrë;

c) Nëse nuk mund të gjendet se cilit prej transportuesve u takon detyrimi për humbjen ose dëmtimin, shuma e kompensimit ndahet ndërmjet të gjithë transportuesve sipas parashikimit në (b) më sipër.

Neni 38

Nëse njëri nga transportuesit falimenton, pjesa e kompensimit që kërkohet prej tij dhe është e papaguar prej tij ndahet ndërmjet transportuesve të tjerë në raport me pjesën e pagesës për transportin që ata duhet të marrin.

Neni 39

1. Asnjëri nga transportuesit kundër të cilëve është ngritur një pretendim në bazë të neneve 37 dhe 38 nuk ka të drejtë të kundërshtojë vlefshmërinë e pagesës së bërë nga transportuesi që ka ngritur pretendimin nëse shuma e kompensimit është caktuar nga një organ gjyqësor pasi transportuesit të parë t'i jetë bërë njoftim i rregullt në lidhje me gjykimin dhe mundësinë e tij për t'u paraqitur.

2. Një transportues që dëshiron të ndjekë rrugën gjyqësore për të ekzekutuar të drejtën e tij të kompensimit mund të ngrejë një pretendim para një gjykate ose organi kompetent në vendin ku njëri nga transportuesit përkatës ka vendbanimin e zakonshëm ose ka vendin kryesor të biznesit ose degën apo agjencinë nëpërmjet të cilës është përpiluar kontrata e transportit. Të gjithë transportuesit përkatës mund të bëhen të paditur në të njëjtën padi.

3. Dispozitat e nenit 31, paragrafët 3 dhe 4, zbatohen për vendimet e dhëna në gjykimet e përmendura në nenet 37 dhe 38.

4. Dispozitat e nenit 32 zbatohen për pretendimet ndërmjet transportuesve. Megjithatë, afati i parashkrimit fillon ose në datën e vendimit përfundimtar gjyqësor që cakton shumën e kompensimit që paguhet në bazë të dispozitave të kësaj Konvente, ose, nëse nuk ka vendim të tillë gjyqësor, nga data faktike e pagesës.

Neni 40

Transportuesit janë të lirë të bien dakord ndërmjet tyre për dispozita të ndryshme nga ato të neneve 37 dhe 38.

KAPITULLI VII PAVLEFSHMËRIA E DISPOZITAVE NË KUNDËRSHTIM ME KONVENTËN

Neni 41

1. Në pajtim me dispozitat e nenit 40, çdo dispozitë që do të devijonte drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt nga dispozitat e kësaj Konvente është e pavlefshme. Pavlefshmëria e një dispozite të tillë nuk bën që edhe dispozitat e tjera në kontratë të jenë të pavlefshme.

2. Veçanërisht, një privilegj nga siguracioni në favor të transportuesit ose çdo dispozitë e ngjashme apo ndonjë dispozitë që zhvendos barrën e provës është e pavlefshme.

KAPITULLI VIII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 42

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim ose aderim nga vendet anëtare të Komisionit Ekonomik të Europës dhe vendet e pranuar në Komision në cilësinë konsultative në bazë të paragrafit 8 të termave të referencës së Komisionit.

2. Këto vende që mund të marrin pjesë në aktivitete të caktuara në Komisionin Ekonomik të Europës, në pajtim me paragrafin 11 të termave të referencës së Komisionit, mund të bëhen palë kontraktuese në këtë Konventë duke aderuar në të pas hyrjes së saj në fuqi.

3. Konventa është e hapur për nënshkrim deri më duke përfshirë dhe 31 gushtin 1956. Pas kësaj, ajo është e hapur për aderim.

4. Kjo Konventë ratifikohet.

5. Ratifikimi ose aderimi realizohet nëpërmjet depozitimit të një instrumenti te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 43

1. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pasi pesë nga vendet e përmendura në nenin 42 paragrafi 1, të kenë depozituar instrumentet e ratifikimit ose aderimit.

2. Për çdo vend që ratifikon ose aderon në të pasi pesë vende të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose aderimit, kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pasi vendi përkatës të ketë depozituar instrumentin e tij të ratifikimit ose aderimit.

Neni 44

1. Çdo palë kontraktuese mund ta denoncojë këtë Konventë duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi hyn në fuqi dymbëdhjetë muaj pas datës së marrjes nga Sekretari i Përgjithshëm i njoftimit të denoncimit.

Neni 45

Nëse pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente numri i palëve kontraktuese pakësohet, si rezultat i denoncimeve, në më pak se pesë, Konventa pushon së qeni në fuqi nga data në të cilën ka hyrë në fuqi denoncimi i fundit i këtyre denoncimeve.

Neni 46

1. Çdo vend, në momentin e depozitimit të instrumentit të ratifikimit ose aderimit ose në çdo moment pas kësaj, mund të deklarojë me anë të njoftimit drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara që kjo Konventë shtrihet në të gjithë ose në ndonjë pjesë territori për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit ai është i përgjegjshëm. Konventa shtrihet në territorin ose pjesët e territorit të caktuara në njoftim nga data e nëntëdhjetë pas marrjes nga Sekretari i Përgjithshëm ose, nëse në atë ditë Konventa nuk ka hyrë në fuqi, në momentin e hyrjes së saj në fuqi.

2. Çdo vend që ka bërë një deklaratë, në bazë të paragrafit të mësipërm, që e shtrin këtë Konventë në një pjesë territori të caktuar për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit është i përgjegjshëm, mund ta denoncojë këtë Konventë, në mënyrë të veçantë, në lidhje me këtë pjesë territori në pajtim me dispozitat e nenit 44.

Neni 47

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, të cilën palët nuk janë në gjendje ta zgjidhin me bisedime ose mjete të tjera, me kërkesë të njëres prej palëve kontraktuese përkatëse mund t'i referohet për zgjidhje Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Neni 48

1. Secila palë kontraktuese, në momentin e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit në këtë Konventë, mund të deklarojë se ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga neni 47 i Konventës. Palët e tjera kontraktuese nuk janë të detyruara nga neni 47 në lidhje me çdo palë kontraktuese që ka bërë një rezervë të tillë.

2. Çdo palë kontraktuese, që ka bërë një rezervë sipas parashikimit të parashikuar në paragrafin 1 mund, ta tërheqë në çdo kohë një rezervim të tillë duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

3. Nuk lejohet asnjë rezervë tjetër për këtë Konventë.

Neni 49

1. Pasi kjo Konventë të ketë qenë në fuqi për tre vjet, çdo palë kontraktuese, nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, mund të kërkojë të thirret një konferencë për qëllimin e rishikimit të Konventës. Sekretari i Përgjithshëm njofton të gjitha palët kontraktuese në lidhje me kërkesën dhe një konferencë rishikuese thirret nga Sekretari i Përgjithshëm nëse, brenda një afati prej katër muajsh pas datës së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm, jo më pak se një e katërta e palëve kontraktuese e njoftojnë atë për aprovimin e tyre për kërkesën.

2. Nëse thirret një konferencë në pajtim me paragrafët e mësipërm, Sekretari i Përgjithshëm njofton të gjitha palët kontraktuese dhe i fton ato të paraqesin brenda një afati prej tre muajsh ato propozime që ato duan të shqyrtohen nga Konferenca. Sekretari i Përgjithshëm e qarkullon agjendën provizore të konferencës së bashku me tekstet me këto propozime të gjitha shtetet kontraktuese të paktën tre muaj para datës në të cilën është caktuar të mbahet Konferenca.

3. Sekretari i Përgjithshëm fton në çdo konferencë që thirret në pajtim me këtë nen të gjitha vendet e përmendura në nenin 42 paragrafi 1 dhe vendet që janë bërë palë kontraktuese në bazë të nenit 42 paragrafi 2.

Neni 50

Përveç njoftimeve të parashikuara në nenin 49, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara njofton vendet e përmendura në nenin 42 paragrafi 1 dhe vendet që janë bërë palë kontraktuese në bazë të nenit 42 paragrafi 2 në lidhje me:

- a) Ratifikimet dhe aderimet në bazë të nenit 42;
- b) Datat e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në pajtim me nenin 43;
- c) Denoncimet në bazë të nenit 44;
- d) Pushimin e efektit të kësaj Konvente në bazë të nenit 45;
- e) Njoftimet e marra në pajtim me nenin 46;
- f) Deklarimet dhe njoftimet e marra në pajtim me nenin 48, paragrafët 1 dhe 2.

Neni 51

Pas 31 gushtit 1956, origjinali i kësaj Konvente depozitohet te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili u transmeton kopje të vërtetuara autentike secilit prej vendeve që përmenden në nenin 42, paragrafët 1 dhe 2.

Si dëshmi e kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë për këtë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Gjenevë, më nëntëmbëdhjetë maj, një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë, në një kopje të vetme në gjuhët angleze dhe franceze, secili nga tekstet është njolloj autentik.

PROTOKOLLI I NËNSHKRIMIT

Duke kaluar në nënshkrimin e Konventës mbi Kontratën për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave, të nënshkruarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë rënë dakord për deklarimin dhe shpjegimin e mëposhtëm:

1. Kjo Konventë nuk zbatohet në trafikun ndërmjet Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe Republikës së Irlandës.

2. Ad Nen 1, paragrafi 4.

Të poshtëshënuarit marrin përsipër të bisedojnë në lidhje me konventat që të rregullojnë kontratat për transportin e mobilieve dhe transportin e përzier.

Si dëshmi e kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë për këtë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në Gjenevë, më nëntëmbëdhjetë maj, një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë, në një kopje të vetme në gjuhët angleze dhe franceze, secili nga tekstet është njëlloj autentik.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK	1500
(2006).....	
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
.....	
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

Botime të reja

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

Hyri në shtyp më 28.4.2006
Doli nga shtypi më 3.5.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë